



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE  
KËSHILLI DREJTUES**

**V E N D I M Q A R K U L L U E S**

**Nr.4 , datë 25.03.2020**

**PËR**

**“PEZULLIMIN E MBLEDHJEVE TË KËSHILLIT DREJTUES NË SELINË E AKEP  
DHE REALIZIMIN E PROCESIT TË VENDIMMARRJES NËPËRMJET MJETEVE TË  
KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE, DERI NË PËRFUNDIMIN E PERIUdhËS SË  
INFEKSIONIT TË SHKAKTUAR NGA COVID-19”.**

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), me pjesëmarrjen e:

Z.	Tomi	Frashëri	Kryetar
Znj.	Edlira	Dvorani	Anëtar
Znj.	Ketrin	Topçiu	Anëtar
Znj.	Xhoana	Lilaj	Anëtar

dhe sekretare Znj. Hasime Ferati, në mbledhjen e datës 25.03.2020, bazuar në përcaktimet e nenit 115, të Ligjit nr.9918, datë 19.05.2008, “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe Rregullores së Brendshme të Funkcionimit të Këshillit Drejtues të AKEP, miratuar me Vendimin nr.7, datë 16.02.2017, të Këshillit Drejtues të AKEP, shqyrtoi çështjen me objekt:

- **Pezullimin e mbledhjeve të Këshillit Drejtues në selinë e AKEP dhe realizimin e procesit të vendimmarrjes nëpërmjet mjeteve të komunikimeve elektronike, deri në përfundimin e periudhës së infeksionit të shkaktuar nga COVID-19”.**

**BAZA LIGJORE:**

1. Neni 114 dhe 115 i Ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar (**Ligji nr.9918/2008**);
2. Ligj nr.44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë” (**Ligji nr. 44/2015**);
3. Ligji nr.8480, datë 27.05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale”;

4. Neni 5, i Aktit Normativ të Këshillit të Ministrave nr.3, datë 15.03.2020, “Për marrjen e masave të veçanta administrative gjatë kohëzgjatjes së periudhës së infeksionit të shkaktuar nga COVID-19” (*Akti Normativ nr.3/2020*), i ndryshuar;
5. Vendim i Këshillit të Ministrave nr.243, datë 24.03.2020 “Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore”;
6. Nenit 12, i Rregullores së Brendshme për Funkcionimin e Këshillit Drejtues të AKEP, miratuar me VKD nr.7, datë 16.02.2017.
7. Urdhrat e Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, nr.156, datë 10.03.2020 “Për marrjen e masave të veçanta në parandalimin e përhapjes së infeksionit të shkaktuar nga COVID-19” dhe nr.193, datë 20.03.2020 “Për mbylljen apo kufizimin e lëvizjes në RSH” të nxjerra për mbrojtjen e shëndetit të popullatës, nga infeksioni i shkaktuar nga COVID-19.

### **K Ë S H I L L I D R E J T U E S:**

Nga shqyrtimi i materialit shkresor mbi çështjen, si më poshtë:

- a) Relacioni shpjegues i projektaktit;
- b) Projektakti i formatuar;

Duke pasur në vëmendje situatën e jashtëzakonshme që ka përfshirë vendin, si pasojë e shpalljes së pandemisë për shkak të përhapjes së sëmundjes infektive COVID -19,

### **V Ë R E N:**

1. Procedura e zhvillimit të mbledhjeve të Këshillit Drejtues të AKEP, është përcaktuar qartë në Ligjin nr.9918/2008 dhe Ligjin nr.8480/1999, si dhe në Rregulloren e Brendshme për Funkcionimin e Këshillit Drejtues të AKEP. Në nenin 12, të Rregullores së sipërcituar është parashikuar se mbledhja e Këshillit Drejtues zhvillohet sa herë që vlerësohet e nevojshme, por jo më pak se një herë në muaj.
2. Akti Normativ i Këshillit të Ministrave nr.3, datë 15.03.2020, ka përcaktuar masat e veçanta administrative në kuadër të parandalimit të përhapjes së mëtejshme të sëmundjes infektive që shkaktohet nga COVID-19, në territorin e Republikës së Shqipërisë. Neni 5 i Aktit Normativ nr.3/2020 parashikon mundësinë e realizimit të vendimmarrjes së organeve kolegjiale nëpërmjet mjeteve të komunikimeve elektronike. Akti normativ ka karakter të përkohshëm dhe do të zbatohet për aq kohë sa dhe do të zgjasë periudha e infeksionit të shkaktuar nga COVID-19.
3. Nisur nga ky kontekst ligjor, Këshilli Drejtues i AKEP, në vlerësim dhe të situatës emergjente që po kalon vendi si pasojë e përhapjes së infeksionit të shkaktuar nga COVID-19, dhe shpalljes së gjendjes së pandemisë, gjykon të nevojshëm pezullimin e

procedurës së zhvillimit të mbledhjeve në selinë e AKEP, dhe vazhdimin e ushtrimit të veprimtarisë, për aq sa do të jetë e mundur, nëpërmjet mjeteve të komunikimit elektronik.

4. Këshilli Drejtues i AKEP, vlerëson se një vendim i tillë vjen në përputhje dhe me masat marra në kuadër të shpalljes së gjendjes së jashtëzakonshme si dhe masat e shëndetit publik marrë nga organet kompetente dhe më konkretisht Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nëpërmjet Urdhrave specifik, për parandalimin dhe vënien nën kontroll të infeksionit të shkaktuar nga COVID-19. Pezullimi i zhvillimit të mbledhjeve fizike të anëtarëve të KD, nuk kufizon mundësinë e zhvillimit të veprimtarisë së çdo anëtari nëpërmjet mjeteve të komunikimit elektronik.
5. Vendimi për pezullimin e zhvillimit të mbledhjeve të Këshillit Drejtues në selinë e AKEP, natyrisht ka karakter të përkohshëm, për aq kohë sa do të zgjasë dhe periodha e infeksionit nga COVID-19.

### **P Ë R K Ë T O A R S Y E:**

Në mbështetje të nenit 115, të Ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, nenit 5, të Aktit Normativ të Këshillit të Ministrave nr.3, datë 15.03.2020, Këshilli Drejtues i AKEP,

### **V E N D O S I:**

1. Të pezullojë përkohësisht zhvillimin e mbledhjeve të Këshillit Drejtues në selinë e AKEP, si pasojë e infeksionit të shkaktuar nga COVID-19 dhe shpalljes së gjendjes së pandemisë.
2. Ky vendim, ka efekt të përkohshëm, deri në përfundimin e përhapjes së infeksionit të COVID-19.
3. Vendimmarrja e Këshillit Drejtues, do të kryhet, për aq sa do të jetë e mundur, nëpërmjet mjeteve të komunikimeve elektronike.
4. Ky vendim publikohet në faqen zyrtare të internetit të AKEP, [www.akep.al](http://www.akep.al).

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

<b>Kryetar</b>	<b>Anëtar</b>	<b>Anëtar</b>	<b>Anëtar</b>
<b>Tomi Frashëri</b>	<b>Edlira Dvorani</b>	<b>Ketrin Topçiu</b>	<b>Xhoana Lilaj</b>